

20110531463

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN**  
**E LIGJIT PËR VEPRIMTARI HOTELIERE**

Neni 1

Në Ligjin për veprimtari hoteliere ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 62/2004, 89/2008 dhe 115/10), në nenin 12 paragrafi 1 ndryshohet si vijon:

"Veprimtaria hoteliere mund të kryhet në objekte afariste, apo lokale në objekte afariste banesore dhe banesore afariste, të rregulluara dhe pajisura për të ofruar shërbime hoteliere, nëse janë plotësuar kushtet për kryerjen e aktiviteteve hoteliere të percaktuara me këtë ligj."

Neni 2

Në nenin 21 paragrafi 1 fjalet: "të paguaje kompensim për ofrimin e shërbimeve" zëvendësohen me fjalet: "të parashtrije kërkesë për leshimin e licences në formular për kompensim të paguar në Ministrinë e Ekonomisë për të ofruar shërbime për:".

Në alinene 2 shumat "4 000 deri në 8 000", zëvendësohen me shumat "5 000 deri në 7 000".

Në alinene 3 shumat "7 500", zëvendësohen me shumat "7 000 deri në 10 000".

Pas paragrafit 3 shtohet paragrafi i ri 4, si vijon:

"Formen dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni, i percakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e hotelierisë."

Neni 3

Pas nenit 21 shtohen dy nene të reja 21-a dhe 21-b, si vijojnë:

"Neni 21-a

Kunder aktvendimit të ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelierisë, me të cilën është refuzuar kërkesa për leshim të licences mund të parashtrihet ankese në Komisionin Shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallën e dytë.

Neni 21-b

Licenca për kryerjen e veprimtarisë hoteliere në bar, kabare, disko klub, dhe disko klub në vend të hapur hiqet me vendim të ministrit, në rastë kur bartesi i licences nuk i plotëson kushtet e percaktuara në pajtim me këtë ligj.

Kunder aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni mund të parashtrihet ankese te Komisioni Shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë nga marrëdhënia e punës në shkallë të dytë".

Neni 4

Në nenin 22 paragrafi 1 pas numrit "20" shtohen fjalet: "të këtij ligji" kurse fjala "tete" zëvendësohet me numrin "15".

Paragrafi 2 fshihet.

Paragrafi 3 behet paragraf 2.

Neni 5

Pas nenit 22 shtohet nen i ri 22-a, si vijon:

"Neni 22-a

Nese organi i administrates shtetore kompetente për e punet nga sfera e hotelerise nuk merr aktvendim për leshimin e licences, respektivisht nuk merr aktvendim për refuzimin e kerkeses për leshimin e licences brenda periudhes së percaktuar në neni 22 paragrafi 1 të ketij ligji, parashtruesi i kerkeses ka të drejte që në afat prej tri diteve të punes të parashtroje kerkese te sekretaria e ministrit i cili udheheq me organin e administrates shtetore kompetent për punet nga sfera e hotelerise, për miratimin e aktvendimit për kerkesen e parashtruar.

Formen dhe permbajtjen e kerkeses nga neni 22 paragrafi 1 i ketij ligji dhe paragrafit 1 të ketij neni i percakton ministri i cili udheheq me organin e administrates shtetore kompetente për punet nga sfera e hotelerise.

Me kerkesen nga paragrafi 1 i ketij neni, parashtruesi i kerkeses dorezon edhe kopje të kerkeses nga neni 22 paragrafi 1 i ketij neni.

Ministri i cili udheheq me organin e administrates shtetore kompetent për punet nga sfera e hotelerise, detyrohet që në afat prej pese diteve pune nga dita e parashtrimt të kerkeses nga paragrafi 1 i ketij neni te sekretaria e Ministrit, të marre aktvendim me të cilin kerkesa nga paragrafi 1 i ketij neni pranohet apo refuzohet. Nese ministri i cili udheheq me administraten shtetore kompetente për punet nga sfera e hotelerise nuk ka sekretari, kerkesa dorezohet në sekretarine e selise së organit të administrates shtetore kompetent për punet në sferen e turizmit.

Nese ministri i cili udheheq me organin e administrates shtetore kompetent për punet nga sfera e hotelerise, nuk merr aktvendim në afatin nga paragrafi 4 i ketij neni, parashtruesi i kerkeses mund ta njoftoje Inspektoratin Shtetor Administrativ në afat prej pese diteve të punes.

Inspektori eshte i obliguar që në afat prej dhjete ditesh nga marrja e njoftimit sipas paragrafit 5 të ketij neni, të kryeje mbikeqyrje ne organin e administrates shtetore kompetente për punet nga sfera e hotelerise, nese eshte kryer procedura në pajtim me ligjin dhe e brenda tri diteve të punes nga dita e mbikeqyrjes së kryer ta informoje parashtruesin e kerkeses për masat e ndermarra.

Inspektori i Inspektoratit Shtetor Administrativ pas mbikeqyrjes së kryer sipas ligjit miraton aktvendim me të cilin e obligon ministrin që udheheq me administraten shtetore kompetent për punet nga sfera e hotelerise, që brenda dhjete ditesh pune të vendose për kerkesen e paraqitur, perkatesisht ta pranoje ose refuzoje kerkesen dhe ta njoftoje inspektorin për aktin e miratuar. Me kerkese dorezohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kerkesen e parashtruar.

Nese ministri i cili udheheq me organin e administrates shtetore kompetent për punet nga sfera e hotelerise nuk vendos në afatin nga paragrafi 7 i ketij neni, inspektori i do të paraqese kerkese për fillimin e procedures kundervajtese për kundervajtjen e percaktuar ne Ligjin për Inspeksion administrativ dhe do të percaktoje afat plotesues prej pese ditesh pune në të cilin funksionari i cili udheheq me organin do të vendose për kerkesen për cfare në të njejtin afat duhet ta njoftoje inspektorin për aktin e miratuar. Me kerkese dorezohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kerkesen e parashtruar. Inspektori në afat prej tri diteve të punes e informon parashtruesin e kerkeses për masat e ndermarra.

Nese ministri i cili udheheq me organin e administrates shtetore kompetent për punet nga sfera e hotelerise, nuk vendos edhe në afatin plotesues nga paragrafit 8 i ketij neni, inspektori brenda tri diteve te punes do të paraqese kallezim te prokurori publik kompetent dhe në atë afat do ta informoje parashtruesin e kerkeses për masat e ndermarra.

Nese inspektori nuk vepron në baze të njoftimit nga paragrafi 6 i ketij neni, parashtruesi i kerkeses brenda pese diteve te punes ka të drejte te paraqese kundershtrim te sekretaria e drejtorit të Inspektoratit Shtetor Administrativ. Nese drejtori nuk ka sekretari, kerkesa parashtrohet në sekretarine e selise së Inspektoratit Shtetor Administrativ.

Drejtor i Inspektoratit Shteteror Administrativ, detyrohet që në afat prej tri ditësh pune nga pranimit i kundërshtimit nga paragrafi 10 i këtij neni dhe nëse konstatohet se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit nga parashtruesi në pajtim me paragrafet 6 dhe 7 të këtij neni dhe/ose nuk dorezon fletëparaqitje në pajtim me paragrafet 8 dhe 9 të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ do të paraqesë kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuara në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune në të cilin inspektori do të kryejë mbikeqyrje nëse është zbatuar procedura sipas ligjit dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e kryerjes së mbikeqyrjes ta njoftojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

Nëse inspektori nuk vepron edhe në afatin plotësues nga paragrafi 11 i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ do të paraqesë kallelzim të prokurorit publik kompetent, kundër inspektorit dhe brenda tri ditësh pune do ta informojë parashtruesin për masat e marra.

Në rastin nga paragrafi 12 i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ, menjëherë e më së voni në afat prej një dite pune, do të autorizojë inspektor tjetër për të kryer mbikeqyrje menjëherë.

Në rast nga paragrafi 13 i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Administrativ Shteteror do të paraqesë kallelzim të prokurorit publik kompetent kundër inspektorit dhe brenda tri ditësh pune do ta informojë parashtruesin e kërkesës.

Nëse drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ nuk vepron në përputhje me paragrafin 11 të këtij neni, parashtruesi mund të paraqesë kallelzim të prokurorit publik kompetent brenda të tërësive të punës.

Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e hotelerisë, nuk vendos në afatin nga paragrafi 9 i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngrihet kontest administrativ para Gjykatës Administrative.

Procedura para Gjykatës Administrative është urgjente.

Akti nenligjor nga paragrafi 2 i këtij neni miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të këtij ligji.

Pas miratimit të aktit nenligjor nga paragrafi 2 i këtij neni i njëjti menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh do të publikohet në ueb faqen e internetit të organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë".

#### Neni 6

Në nenin 23 paragrafi 1 pika 2 ndryshohet si vijon:

"objektet hotelierike për ushqim nga neni 19 paragrafi 1 pika 1 të këtij ligji, të cilat paraqesin një teresi ndërtimore të vendosur në vendkalime kufitare, aeroporte dhe stacione hekurudhore mund të punojnë nga ora 00,00 deri në ora 24,00;"

Paragrafi 3 ndryshohet si vijon:

"Keshilli i komunes ose të Keshilli i Qytetit të Shkupit, për manifestime të caktuara, turistike kulturore dhe të llojeve tjera, të përfshira në programet vjetore, mund ta vazhdojnë orarin e punës më së shumti për dy orë, për objektet hotelierike nga paragrafi 1 i këtij neni, por në kohezgjatje më së shumti deri në tri dite."

#### Neni 7

Në nenin 28 paragrafi 4 numri "15" zëvendësohet me numrin "30".

Paragrafi 5 fshihet.

Në paragrafin 6 i cili behet paragraf 5 fjalet: "Komisioni i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për Vendimmarrje në Procedure Administrative në Shkallë të Dytë nga Sfera e Hotelierisë" zëvendësohen me fjalet: "Komisioni Shteteror për Vendimmarrje në Procedure Administrative dhe Procedure të Marredhenies së Punës në Shkallë të Dytë".

#### Neni 8

Në nenin 29 paragrafi 2 fjala "permban" zevendesohet me fjalet: "parashtrohet në formular i cili permban:".

Pas paragrafit 2 shtohen dy paragrafe të rinj 3 dhe 4, si vijojne:

"Kerkesa nga paragrafi 2 i ketij neni parashtrohet në dy kopje identike me shtesen e deshmive.

Formen dhe permbajtjen e formularit të kerkeses nga paragrafi 2 i ketij neni i percakton ministri i cili udheheq me organin e administrates shteterore kompetent për punet nga sfera e hotelierise."

#### Neni 9

Pas nenit 29 shtohet nen i ri 29-a, si vijon:

##### "Neni 29-a

Nese komisionet nuk miratojne aktvendim për kategorizim, respektivisht nuk miratojne aktvendim për refuzimin e kerkeses për kategorizim në afatin nga neni 28 paragrafi 4, parashtruesi i kerkeses ka të drejte që në afat prej tri diteve të punes të parashtroje kerkesa te sekretaria e ministrit i cili udheheq me organin e administrates shteterore kompetent për punet nga sfera e hotelierise, dhe ministri, për miratimin e aktvendimit për kerkesen e parashtruar.

Formen dhe permbajtjen e kerkeses nga neni 29 paragrafi 1 i ketij ligji dhe paragrafi 1 i ketij neni, i percakton ministri i cili udheheq me organin e administrates shteterore kompetent për punet nga sfera e hotelierise.

Me kerkesen nga paragrafi 1 i ketij neni, parashtruesi i kerkeses dorezon edhe kopje të kerkeses nga neni 29 paragrafi 1 i ketij ligji.

Ministri i cili udheheq me organin e administrates shteterore kompetent për punet nga sfera e hotelierise, detyrohet që në afat prej pese ditesh pune nga dita e parashtrimt të kerkeses nga paragrafi 1 i ketij neni te sekretaria e ministrit, të marre aktvendim me të cilin kerkesa nga paragrafi 1 i ketij neni pranohet apo refuzohet. Nese ministri i cili udheheq me administraten shteterore kompetente për punet nga sfera e hotelierise nuk ka sekretari, kerkesa dorezohet në sekretarine e selise së organit të administrates shteterore kompetent për punet në sferen e turizmit.

Nese ministri i cili udheheq me organin e administrates shteterore kompetent për punet nga sfera e hotelierise, nuk merr aktvendim në afatin nga paragrafi 4 i ketij neni, parashtruesi i kerkeses mund ta njoftoje Inspektoratin Shteteror Administrativ në afat prej pese diteve të punes.

Inspektori eshte i obliguar që në afat prej dhjete ditesh nga marrja e njoftimit sipas paragrafit 5 të ketij neni, të kryeje mbikeqyrje ne organin e administrates shteterore kompetente për punet nga sfera e hotelierise, nese eshte kryer procedura ne pajtim me ligjin dhe brenda tri diteve të punes nga dita e mbikeqyrjes së kryer ta informoje parashtruesin e kerkeses.

Inspektori i Inspektoratit Shteteror Administrativ pas mbikeqyrjes së kryer sipas ligjit, merr aktvendim me të cilin e obligon ministrin që udheheq me administraten shteterore kompetent për punet nga sfera e hotelierise, që brenda dhjete ditesh pune të vendose për kerkesen e paraqitur, perkatesisht ta pranoje ose refuzoje kerkesen dhe ta njoftoje inspektorin për aktin e miratuar. Me kerkesa dorezohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kerkesen e parashtruar.

Nese ministri i cili udheheq me organin e administrates shteterore kompetent për punet nga sfera e hotelierise nuk vendos brenda afatit nga paragrafi 7 i ketij neni, inspektori do të paraqese kerkesa për fillimin e procedures kundervajtese për kundervajtjen e percaktuar ne Ligjin për Inspeksion administrativ dhe do të percaktoje afat plotesues prej pese ditesh pune në të cilin funksionari i cili udheheq me organin do të vendose për kerkesen për cfare në të njejtin afat duhet ta njoftoje inspektorin për aktin e miratuar. Me kerkesa dorezohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kerkesen e parashtruar. Inspektori në afat prej tri diteve të punes e informon parashtruesin e kerkeses për masat e marra.

Nese ministri i cili udheheq me organin e administrates shteterore kompetent për punet nga sfera e hotelerise, nuk vendos edhe në afatin plotesues nga paragrafi 8 i ketij neni, inspektori brenda tri diteve të punes do të paraqese kallezim te prokurori publik kompetent dhe në atë afat do ta informoje parashtruesin e kerkeses për masat e ndermarra.

Nese inspektori nuk vepron në baze të njoftimit nga paragrafi 6 i ketij neni, parashtruesi i kerkeses brenda pese diteve te punes ka të drejte të paraqese kundershtrim te sekretaria e drejtorit të Inspektoratit Shteteror Administrativ. Nese drejtori nuk ka sekretari, kerkesa parashtrohet në sekretarine e selise së Inspektoratit Shteteror Administrativ.

Drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ, detyrohet që në afat prej tri ditesh pune nga pranimi i kundershtrimit nga paragrafi 10 i ketij neni dhe nese konstaton se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit nga parashtruesi në pajtim me paragrafet 6 dhe 7 të ketij neni dhe/ose nuk dorezon fleteparaqitje në pajtim me paragrafet 8 dhe 9 të ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ do të paraqese kallezim për fillimin e procedures kundervajtese për kundervajtje të percaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin dhe do të percaktoje afat plotesues prej pese ditesh pune në të cilin inspektori do të kryeje mbikeqyrje nese eshte zbatuar procedura sipas ligjit dhe në afat prej tri ditesh pune nga dita e kryerjes së mbikeqyrjes ta njoftoje parashtruesin e kerkeses për masat e ndermarra.

Nese inspektori nuk vepron edhe në afatin plotesues nga paragrafin 11 i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ do të paraqese kallezim te prokurori publik kompetent, kunder inspektorit dhe brenda tri ditesh pune do ta informoje parashtruesin për masat e marra.

Në rastin nga paragrafi 12 i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ, menjehere e më së voni në afat prej një dite pune, do të autorizojë inspektor tjetër për të kryer mbikeqyrje menjehere.

Në raste nga paragrafi 13 i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Administrativ Shteteror do të paraqese kallezim te prokurori publik kompetent kunder inspektorit dhe brenda tri ditesh pune do ta informoje parashtruesin për masat e marra.

Nese drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ nuk vepron në perputhje me paragrafin 11 të ketij neni, parashtruesi mund të paraqese kallezim te prokurori publik kompetent brenda tete diteve të punes.

Nese ministri i cili udheheq me organin e administrates shteterore kompetente për kryerjen e puneve nga sfera e hotelerise, nuk vendos në afatin nga paragrafi 9 i ketij neni, parashtruesi i kerkeses mund të ngrite kontest administrativ para Gjykates Administrative.

Procedura para Gjykates Administrative eshte urgjente.

Akti nenligjor nga paragrafi 2 i ketij neni miratohet në afat prej 15 ditesh nga dita e miratimit të ketij ligji.

Pas miratimit të aktit nenligjor nga paragrafi 2 i ketij neni i njejtë menjehere, e më së voni në afat prej 24 oresh, publikohet në ueb faqen e internetit të organit të administrates shteterore kompetent për punet nga sfera e hotelierise".

#### Neni 10

Në nenin 33 pas paragrafit 5 shtohet paragraf i ri 6, si vijon:

"Komisioni në baze të kerkeses ose fleteparaqitjes, mund të inspektojë dhe të percaktojë nese objekti hotelerik i ploteson standardet për të cilat me aktvendim i eshte percaktuar kategoria e caktuar, para afatit nga paragrafi 1 i ketij neni. Nese Komisioni percakton se objekti hotelerik u shmanget standardevë në baze të cilave i eshte percaktuar kategoria, do të leshojë aktvendim të ri për kategorizim në kategori adekuate për të cilën i ploteson standardet".

#### Neni 11

Në nenin 36 paragrafi 2 fshihet.

#### Neni 12

Pas nenit 57 shtohet nen i ri 57-a, si vijon:

##### "Neni 57-a

Në procedurën e mbikeqyrje inspektues zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikeqyrje inspektuese dhe Ligjit për Inspektoratin Shtetëror të Tregut, nese me kete ligj nuk eshte rregulluar ndryshe."

#### Neni 13

Në nenin 60 paragrafi 8 ndryshohet si vijon:

"Kunder aktvendimit të Inspektorit Shtetëror të Tregut nga paragrafi 1 i ketij neni mund të parashtrohet ankese në afat prej tete ditesh nga dita e marrjes së aktvendimit te Komisioni i Ankesave i formuar në pajtim me Ligjin për Inspektoratin Shtetëror të Tregut."

Pas paragrafit 8 shtohet paragrafi i ri 9, si vijon:

"Kunder aktvendimit të inspektorit të autorizuar komunal, respektivisht të qytetit të Shkupit nga paragrafi 1 i ketij neni mund parashtrohet ankese në afat prej tete ditesh nga dita e marrjes së aktvendimit te Komisioni i Ankesave i formuar në pajtim me Ligjin për mbikeqyrje inspektuese."

Paragrafi 9 behet paragraf 10.

#### Neni 14

Në nenin 68 paragrafi 1 në fjaline hyrese shuma "1000" zevendesohet me shumen "800".

Në paragrafin 2 shuma "200" zevendesohet me shumen "100".

Në paragrafin 3 shuma "300" zevendesohet me shumen "200".

#### Neni 15

Pas nenit 68 shtohet nen i ri 68-a, si vijon:

##### "Neni 68-a

Gjobe në shume prej 1000 eurosh në kundervlere me denare do t'i shqiptohet personit juridik, për veprimet nga neni 68 paragrafi 1 i ketij ligji.

Gjobe në shume prej 200 eurosh në kundervlere me denare do t'i shqiptohet personit pergjegjes në personin juridik, për veprimet nga neni 68 paragrafi 1 i ketij ligji.

Gjobe në shume prej 300 eurosh në kundervlere me denare do t'i shqiptohet tregtarit individual për veprimet nga neni 68 paragrafi 1 i ketij ligji.

Gjoba nga paragrafet 1, 2 dhe 3 të ketij neni paguhen në raste kur kryeresi i kundervajtjes të cilit i eshte dhene ftesa për pagesen e gjobes aty për aty, në afat prej tete ditesh nuk e paguan gjoben e shqiptuar."

#### Neni 16

Pas nenit 70 shtohet nen i ri 70-a, si vijon:

##### "Neni 70-a

Procedura kundervajtese për kundervajtjet e parapara me kete ligj nuk mund të ngritet as të udhehiqet, nese kalojne 18 muaj nga dita kur eshte kryer kundervajtja."

#### Neni 17

Dispozitat e nenit 3 të ketij ligji me të cilin shtohen dy nene të reja 21-a dhe 21-b, nenit 5 të ketij ligj me të cilin shtohet neni i ri 22-a dhe nenit 7 të ketij ligji me të cilin ndryshohet paragrafi 6 i nenit 28, do të fillojne të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për themelimin e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedure Administrative dhe Procedure të Marredhenies së Punes në Shkalle të Dyte.

Dispozitat e neneve 12 dhe 13 të ketij ligji do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për mbikeqyrje inspektuese.

Neni 18

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvenes i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të percaktojë tekst të spastruar të Ligjit për veprimtari hoteliere.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".